

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

HYN NË FUQI LIGJI NR. 77/2022 "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 133/2015 "PËR TRAJTIMIN E PRONËS DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË KOMPENSIMIT TË PRONAVE"



Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 77/2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", me datë 30.12.2022 dhe me miratimin e ndryshimeve në dy vendimet e Këshillit të Ministrave, përkatësisht VKM nr. 222/2016 dhe VKM nr. 223/2016, Agjencia e Trajtit të Pronave nuk ka më asnjë pengesë ligjore për vijueshmërin e procesit të njohjes dhe kthimit të pronës si dhe të kompensimit të saj. Me ndryshimet ligjore dhe nënligjore, të cilat erdhën në kuadër të rekomandimeve të dhëna nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimin "Beshiri kundër Shqipërisë", si dhe Vendimit nr. 4/2021 të Gjykatës Kushtetuese, Agjencia e Trajtit të Pronave do të filloj procedimin administrativ për ato dosje të patrajuara më parë me vendim si dhe nuk do të ketë më kufizim në kthimin fizik të pronës. Të gjithë ato subjekte të cilët i janë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për kërkesat e patrajuara për njohjen e pronës, kanë të drejtë të heqin dorë nga gjykimi i çështjes dhe të paraqesin kërkesë pranë Agjencisë së Trajtit të Pronave për shqyrtimin e dosjes së tyre. Gjithashtu do të rihapet afati për të vlerësuar financiarisht, të gjitha ato vendime me të drejtë kompensimi të pavlerësuara më parë, nuk do të ketë më vlerësim financiar më pak se 10 për qind sipas zërit kadastral aktual si dhe do të indeksohet shuma e kompensimit deri në pagesën përfundimtare. Subjektet që i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kërkuar vlerësimin financiar, kanë të drejtë të heqin dorë nga gjykimi i çështjes dhe të paraqesin kërkesë pranë Agjencisë së Trajtit të Pronave.

LEXO PËR MË SHUMË *

DREJTORIA E PËRGJITHSHME ANTIKORRUPTION PROPOZON 22 MASA ADMINISTRATIVE DHE JEP 22 REKOMANDIME PËR RASTE KONTROLI DHE DYSHIME PËR KORRUPSION

Drejtoria e Monitorimit të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorruption dhe Drejtoria Operacionale për Çështjet Antikorruption pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korruptionit në Ministrinë e Drejtësisë, kanë vijuar me marrjen e rasteve të dyshuara të korruptionit. Përgjatë muajit maj, pranë dy strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorruption janë marrë e administruar në total 29 ankesa dhe denoncime referuar aktivitetit të institucioneve të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korruptionit, në të gjitha mënyrat e komunikimit (shkresor, email, platforma elektronike). Rastet i adresohen kryesisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoreve vendore të saj, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, etj. Pas verifikimit të hollësishëm të ankesave, janë hartuar 6 raporte përfundimtare në lidhje me hetimet e kryera, në të cilat janë identifikuar elementë të veprimit të parregullta. Në vijim, janë propozuar 22 masa për fillimin e ecurisë disiplinore si dhe janë gjeneruar 22 rekomandime për të forcuar mekanizmat e kontrollit dhe parandalimit të korruptionit. Drejtoria e Përgjithshme Antikorruption është e angazhuar për të ndërmarrë veprime të menjëherësime ndaj shkeljeve të dyshuara dhe për të promovuar integritetin dhe llogaridhëni në institucionet që operojnë në shërbim të qytetarëve.


LEXO PËR MË SHUMË *

MINISTRI I DREJTËSISË FTON NË TRYEZË DISKUTIMI PËR MASAT ANTIKORRUPTION PËRFAQËSUESIT E DHOMAVE DHE SHOQATAVE TË BIZNESIT



Bashkëpunimi me biznesin për politika të vlefshme antikorruption dhe masa eficente veprimi për të garantuar shërbime më të mira publike, mbodhi bashkë në një tryezë diskutimi Ministrin e Drejtësisë në ushtrim të rolit të tij të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korruptionit, z. Ulsi Manja, me drejtues e përfaqësues të dhomave dhe shoqatave të biznesit në vend. Tematika e takimit ishte bashkërendimi i masave për ndërhyrje dhe rritja e bashkëveprimit mes palëve. Ministri Manja paraqiti disa prej iniciativave kundër korruptionit dhe raste të masave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorruption ndaj nëpunësve drejtues dhe zbatues pranë autoritetetve ku është vendosur Rrjeti i Koordinatorëve Antikorruption. Në takim, pjesëmarrësit ndanë mendime dhe përvaja të vlefshme për të fuqizuar kapacitetet dhe ndërtuar ura të reja bashkëpunimi dhe me qëllim rritjen e besimit për vlerat dhe kapacitetet e profesionistëve kundër korruptionit. Aktorët e sektorit privat kerkuan dhe propozuan pasjen e një roli më aktiv të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorruption në parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin e luftës kundër korruptionit në administratën publike edhe në sektorin privat. Drejtoria e Përgjithshme Antikorruption është struktura teknike e organizuar në nivel ekzekutiv për të luftuar korruptionin dhe promovuar integritetin në administratën publike. Palët mbështetën dhe ofruan bashkëpunim të regullt në vijim.

TAKIM NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL ME DHOMËN NDËRKOMBËTARE TË NDËRMJETËSVE



Negocimi, zgjidha e konflikteve me marrëveshje, ndërhyrja që në fazat fillore mund të parandalojë shumë krimet që ndodhin mes të miturve për shkak të konflikteve të pazgjadhura. Per këtë arsyen Qëndra e Parandalimit të Krimave të tilla si Miturve dhe Rinjve dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve nënshkruan marrëveshjen mbi vendosjen e bashkëpunimit të kuadër të zgjidhjes të problematikave me anë të ndërmjetësimit lidhur me rastet e të miturve dhe të rinjve në kontakt/konflikt me ligjin.

LEXO PËR MË SHUMË *

DISKUTIM I HAPUR MES DONATORËVE DHE PARTNERËVE STRATEGJIKË NË KUADËR TË PARANDALIMIT TË KRIMINALITETIT TË TË MITURIT DHE TË RINJIT



Me Agjencinë Austriake për Zhvillim, në një diskutim të hapur mes donatorëve dhe partnerëve strategjikë për zhvillimin e programeve të përbashkëta në kuadër të parandalimit të kriminalitetit të të miturit dhe të rinjtë si dhe rintegrimin pas demimit.

LEXO PËR MË SHUMË *

SEMINAR 'MBI MEKANIZMIN E REFERIMIT TË ÇËSHTJEVE NË NDËRMJETËSIM'



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Albania Foundation for Conflict Resolution, në kuadër të projektit 'Zgjerimi dhe Fuqizimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri' organzoj i seminare, të mbajtura në Tiranë dhe në Shkodër me temën 'Mbi mekanizmin e Referimit të Çështjeve në Ndërmjetësim'. Në këto seminare mori pjesë Kryetarja e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve Zj. Drita Avdyli, punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Paresore Tiranë, Durrës dhe Shkodër, përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse, studentë të Klinikave të ligjit, pranë IAL-ve, me të cilët Drejtoria e Ndihmës Juridike ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

LEXO PËR MË SHUMË *



DISKUTIME RRETH ARRITJEVE DHE SFIDAVE TË SISTEMIT TË DREJTËSISE Në praninë e partnerëve ndërkombëtarë të cilët kanë bashkëshoqëruar jetësimin e Reformës në Drejtësi, institucioneve të pavarura të drejtësisë, shqëjësive civile, si dhe nën asistencën e çmuar të projektit JustAL, diskutuan gjethet e Raportit të Monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të saj të Veprimit për vitin 2022. Në mbledhjen e Komitetit Drejtues Sektoral për reformën në sfidat me të cilat përballet sistemi.

LEXO PËR MË SHUMË *

